



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.A.nr.83/2021

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – koleji i përbërë nga gjyqtarët: Shukri Sylejmani, kryetar, Muhamet Rexha dhe Beshir Islami, anëtarë, në çështjen juridike të gjyqtares të Gjykatës Themelore në Pejë, Forije Zatriqi, në procedurën sipas kërkesës AD/GJTHPE nr. 15/2021, të autoritetit kompetent për fillimin e hetimeve disiplinore në pajtim me Ligjin nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, dhe Ligjin nr. 08/L-003 për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji, duke vendosur sipas ankesës së gjyqtares Florije Zatriqi, të paraqitur kundër vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, nr. 322/2021 datë 8 nëntor 2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më 06.12.2021, merr këtë:

A K T V E N D I M

Konfirmohet vendimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr. 322/2021 datë 8 nëntor 2021, ndërsa ankesa e Florije Zatriqit gjyqtare në Gjykatën Themelore në Pejë, e paraqitur kundër këtij vendimi, refuzohet si e pa bazuar.

A r s y e t i m

Me vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, nr. 322/2021 datë 8 nëntor 2021, është suspenduar nga detyra e gjyqtares Florije Zatriqi, gjyqtare në Gjykatën Themelore në Pejë, deri në një vendim tjetër të Këshillit, dhe gjatë kësaj periudhe gjyqtarja Florije Zatriqi do të pranojë vetëm 50% të pagës mujore, vendim ky i cili hyn në fuqi që nga data 8 nëntor 2021.



Kundër vendimit të lartpërmendur, gjyqtarja Florije Zatriqi me kohë ka paraqitur ankesë për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të ligjit, me propozim që ankesa të miratohet si e bazuar, dhe vendimi i ankimuar të ndryshohet ashtu që të hiqet masa e suspendimit.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në përgjigje në ankesën e gjyqtarës Florije Zatriqi, kontestoi në tërësi thëniet ankimore të saj dhe propozoi që kjo ankesë të refuzohet si e pabazuar, ndërsa vendimi i kontestuar me ankesë, të konfirmohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 15 pika 4 të Ligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe në kuptim të Ligjit nr. 08/L-003 për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji, shqyrtoi ankesën e paraqitur nga gjyqtarja Florije Zatriqi, vendimin e ankimuar, si dhe shkresat e lëndës, dhe gjeti se:

Ankesa e paraqitur nga gjyqtarja Florije Zatriqi, është e pabazuar.

Me vendimin e ankimuar, më datë 8 nëntor 2021 pas shqyrtimit të kërkesës së autoritetit kompetent për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarës Florije Zatriqi, kjo gjyqtare është suspenduar nga detyra e gjyqtarës deri në një vendim tjetër të Këshillit, dhe bazuar në nenin 11 të Rregullores nr. 05/2019, për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve është themeluar Paneli hetimor për të hetuar shkeljen e supozuar disiplinore të gjyqtarës Florije Zatriqi. Këshilli Gjyqësor i Kosovës, duke u bazuar në nenin 2 të Ligjit nr. 08/L-003 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, sipas detyrës zyrtare ka shqyrtuar dhe vlerësuar çështjen e suspendimit të gjyqtarës në fjalë dhe pas diskutimeve me shumicë votash ka vendosur për suspendimin e saj, në tërësi si në dispozitivin e vendimit të ankimuar, duke vlerësuar se suspendimi i gjyqtarës në këtë fazë të procedurës do të krijojë parakushte që Paneli hetimor të hetojë në tërësi çështjen në mënyrë objektive duke pamundësuar çfarëdo ndikimi në procedurën disiplinore dhe duke konstatuar se suspendimi i gjyqtarës në fjalë nuk prejudikon mënyrën e zhvillimit të procedurës dhe as përfundimin e saj, por e lehtëson procesin e hetimit disiplinor. Vendimi është bazuar në nenin 2 të Ligjit nr. 08/L-003 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe në nenin 12 paragrafi 10 të këtij Ligji.

Në një gjendje të tillë të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm vendimin e ankimuar, pasi që i njëjti është në tërësi në Ligj i bazuar,



dhe me këtë rast u pranuan si të bazuara të gjitha konstatimet faktike dhe juridike të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të precizuara në tërësi si në këtë vendim. Suspendimi i gjyqtars Florije Zatriqi ka ardhur gjatë zhvillimit të rregullt të procedurës disiplinore ndaj gjyqtars në fjalë, duke u bazuar në mënyrë të drejtë në nenin 2 të Ligjit nr. 08/L-003 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësine Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, me të cilin neni 12 paragrafi 9 i këtij Ligji riformulohet si vijon: *gjatë procedurës hetimore, Këshilli eksoficio ose me kërkesë të autoritetit kompetent i cili ka kërkuar fillimin e hetimeve mund të suspendoj gjyqtarin ose prokurorin i cili është në hetime nëse një gjë e tillë është e nevojshme duke marrë parasysh seriozitetin e shkeljes së supozuar disiplinore dhe të sigurohet integriteti dhe efektiviteti i hetimeve*. Së këndejmi edhe Gjykata Supreme gjen se përmes këtij vendimi, krijohen parakushtet që Paneli hetimor mund të hetoj në tërësi çështjen në mënyrë objektive duke pamundësuar çfarëdo ndikimi në procedurën disiplinore.

Në këtë kontest, u refuzuan si të pabazuara pretendimet e ankesës se ndryshimi i këtij Ligji ka hy në fuqi më datë 03.11.2021, ndërsa shkelja e supozuar ka ndodhur më datën 23.07.2021, në kohën kur ka qenë në fuqi Ligji për Përgjegjësine Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (Ligji nr.6/L-057) me të cilin nuk ka qenë e paraparë mundësia e suspendimit të gjyqtarit përveç në rast të zhvillimit të një hetimi penal, prandaj sipas ankueses „ *ligji i ri nuk mund të ketë efekt prapaveprues për shkelje që supozohet se ka ndodhur para hyrjes në fuqi të tij, pasi as Ligji i ri nuk e ka parashikuar një mundësi të tillë*”. Këto pretendime ankimore u vlerësuan si të pabazuara ngase, pas hyrjes në fuqi të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e këtij Ligji bëhet e mundur që gjyqtari ose prokurori të suspendohet edhe për shkak të shkeljes së supozuar disiplinore, ashtu siç edhe është vepruar në rastin konkret. Për sqarim, ky ndryshim i Ligjit ka hy në fuqi 15 ditë pas publikimit, pikërisht më datën 06.11.2021, ndërsa vendimi i ankimuar është nxjerrë më datën 08.11.2021. Në Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e këtij Ligji janë gjithsej tri nene, ndër të cilat nuk ka dispozitë kalimtare dhe të fundit e cila kishte për të orientuar në atë se zbatohet apo nuk zbatohet për shkeljet e më parme disiplinore të supozuara, andaj rezulton se ky ndryshim dhe plotësim i këtij Ligji duhet të zbatohet për të gjitha rastet që shqyrtohen pas hyrjes në fuqi të këtij ndryshim-plotësimi të këtij Ligji, me ç’rast është irelevante se shkelja e supozuar ka ndodhur pak më herët. Në çështjen e përgjegjësise disiplinore të gjyqtars nuk ka mundësi të anashkalohet zbatimi i plotësim ndryshimit të këtij Ligji, pasi që ky plotësim ndryshimi i këtij Ligji nuk përmban dispozitë kalimtare dhe



të fundit me të cilën eventualisht do të pengohej zbatimi i këtij ndryshim-plotësimi të Ligjit për shkeljet e supozuara të mëparshme. Kështu që duke marrë parasysh se Këshilli Gjyqësor më datën 8 nëntor 2021, do të thotë, pas hyrjes në fuqi të këtij ndryshim-plotësimi të këtij Ligji në takimin e 270 ka shqyrtuar kërkesën e autoritetit kompetent për inicim të procedurës disiplinore ndaj Florije Zatriqi, ka formuar Panelin hetimor për të hetuar shkeljen e supozuar disiplinore, dhe ka suspenduar nga detyra e gjyqtares këtu ankuesen Florije Zatriqi, Gjykata Supreme vlerëson se në këtë aspekt, pretendimet e ankueses për kundërligjshmërinë e këtij vendimi nuk qëndrojnë si të bazuara.

U vlerësuan si të pabazuara edhe pretendimet tjera ankimore se suspendimi i ankueses këtu gjyqtares Florije është në kundërshtim me nenin 2 të Ligjit nr. 08/L-003 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, të cilës dispozitë i është referuar Këshilli Gjyqësor, me rastin e marrjes së vendimit të kontestuar, ngase nuk është thënë me asnjë fjalë se cila është ajo shkelje disiplinore e supozuar dhe a është e karakterit të tillë që vërtet imponon nevojën e marrjes së një vendimi të tillë, dhe kështu sipas ankueses nuk janë plotësuar kushtet kumulative për suspendimin e saj: 1, që të jetë filluar një hetim për shkeljet disiplinore nga një autoritet kompetent, 2, që shkelja e supozuar disiplinore të jetë serioze dhe 3, që masa e suspendimit do të mundësoj zhvillimin e një hetimi të paanshëm dhe efektiv. Përkundrazi, Gjykata Supreme konsideron se që të tri këto kushte janë plotësuar në rastin e suspendimit të gjyqtares Florije Zatriqi ngase kundër saj është filluar një hetim për shkelje disiplinore nga një autoritet kompetent dhe shkelja e supozuar disiplinore është mjaft serioze, dhe në fund kjo masë e suspendimit mundëson zhvillimin e një hetimi të paanshëm dhe efektiv të përgjegjësisë disiplinore të ankueses-gjyqtares Florije Zatriqi. Në këtë vendim ka qenë jo e domosdoshme që të konstatohen rrethanat përkitazi me llojin, dhe karakterin e shkeljes së supozuar, ngase këto janë evidente në kërkesën e autoritetit kompetent për inicimin e përgjegjësisë disiplinore dhe se për atë shkelje të supozuar do të zhvillohet procedurë disiplinore. Arsyetimi për masën e suspendimit, ka të bëjë kryesisht me bazën ligjore për caktimin e një mase të tillë, e cila pa dyshim ekziston, dhe për sigurimin e kushteve përmes kësaj mase të suspendimit, që Paneli hetimor të hetoj në tërësi çështjen në mënyrë objektive duke pamundësuar çfarëdo ndikimi në procedurën disiplinore. Nga kjo që u tha, rezulton se vendimi i ankimuar është në përputhje të plotë me nenin 2 të Ligjit nr. 08/L-003 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve



dhe Prokurorëve, andaj pretendimet ankimore të ankueses në këtë drejtim u refuzuan si të pa bazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës, pranon në tërësi konstatimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në vendimin e ankimuar, se suspendimi i gjyqtarës nuk prejudikon mënyrën e zhvillimit të procedurës dhe as përfundimin e procedurës, por e lehtëson procesin e hetimit disiplinor, andaj pretendimet ankimore të paraqitura në këtë drejtim u vlerësuan si të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerësoi se ishte irelevant pretendimi ankimor se Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk ka asnjë provë a indikacion se ankuesja ka bërë ndonjë përpjekje për pengimin e zbatimit të procedurës, pengimit të hetimit apo që do të pengonte efikasitetin e hetimeve, pasi që me shqiptimin e masës së suspendimit arrihet që të eliminohet mundësia e këtij pengimi nga ana e ankueses të zhvillimit të hetimit dhe përfundimit të procedurës, dhe kësi soji lehtësohet procesi i hetimit disiplinor, çka është edhe qëllimi ligjor i suspendimit, kështu që nuk është e domosdoshme që të ketë prova dhe indikacione për përpjekjet e ankueses për tentimin e ndikimit apo pengimit të zhvillimit të kësaj procedure nga se suspendimi shqiptohet me qëllim të evitimit të këtij pengimi, e jo pasi që nga ankuesja të tentohet pengimi i zhvillimit të procedurës, apo ndikimi në zhvillimin e kësaj procedure.

Për arsyet e paraqitura më lart, në bazë të nenit 15 pika 5 dhe 6 të Ligjit të lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.


GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

A.A.nr. 83/2021, më 06.12.2021

Kryetari i kolegjit,
Shukri Sylejmani



Republika e Kosovës  Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE


Punëtori i autorizuar
Ovlašćen radnik